

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2021*

**15.03.2021
Ora 11:25**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y.Merkaj, A.Tenolli**
- **Parti Politike:** **PD**

Z.I.Celibashi: Mirëdita të gjithëve, fillojmë seancën publike për shqyrtimin e çështjeve vijuese: Projektvendimin “Për caktimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit në ndërtesa private” pika e parë e rendit të ditës. Pika e dytë ka të bëjë me lirimimin dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-së nr.7 Qarku Shkodër, KZA-së nr.23 Qarku Durrës, KZAZ-së nr.32 Qarku Tiranë, KZAZ-së nr.63 Qarku Berat, KZAZ-së nr.71, KZAZ-së nr.75 Qarku Korçë dhe KZAZ-së nr.91 Qarku Vlorë. I japim fjalën sekretarit për të relatuar projektaktin.

Z. Y. Merkaj: Sipas përcaktimit të nenit 93 të Kodit Zgjedhor Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk është e mundur për arsye objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit apo në një zonë qendre votimi fqinje. Komisioni Rregullator, me Udhëzimin nr.1, të vitit 2020, ka caktuar rregullat dhe kriteret që ndiqen në rastet kur Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore i propozon Komisionit Qendror të

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2021*

kur Kryetari i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve caktimin e vendodhjes së qendrës së votimit në ndërtesa private. Nga Kryetarët e Bashkive për propozimin e përcaktuar, për caktimin e vendndodhjes së qendrës së votimit në ndërtesë private është referuar mungesa e ndërtesave publike në zonën e qendrës së votimit apo në zonën e qendrës së votimit fqinj. Është paraqitur dokumentacioni sipas Udhëzimit nr.1 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator, pozicioni gjeografik i ndërtesave private të propozuara për caktimin e vendodhjes së qendrës së votimit përgjithësisht është në qendër ose afër qendrës së zonës së qendrës së votimit. Konfirmohet se ndërtesat nuk përdoren apo nuk janë në pronësi, pjesërisht apo tërësisht, të një partie politike, kandidati apo të afërmeve të tij, ose kanë shërbyer si zyrë elektorale gjatë fushatës zgjedhore. Gjithashtu është referuar se pronari i ndërtesës private të propozuar është dakord për të përdorur mjedisin përkatës për qendër votimi. Përmes këtij relacioni, paraqiten për miratim propozimet e kryetarëve të njësisë të vetëqeverisjes vendore 61 qendra votimi në ndërtesa private dhe për vendndodhjen e propozuar për 54 qendra votimi, janë referuar edhe të dhënat e dërguara nga Kryetarët e Bashkive në përgjigje të opinionëve të marra nga përfaqësuesit të partive politike.

Z. I. Celibashi: Ne ua kemi dërguar dhe përfaqësuesve të partive politike projektaktin. Kështu që i jap fjalën përfaqësuesve të partive politike për të dhënë mendimin e tyre në lidhje me projektaktin dhe rast pas rasti për secilën për qendrën e votimit, të cilat janë propozuar që të caktohen në ndërtesa private, faleminderit.

Z. I. Kaso përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Komisioner. Projektvendimi i sotëm është një projektvendim i rëndësishëm që rëndom në procese zgjedhore ka qenë objekt diskutimi, për shkak të problematikës, pasi gjithmonë qendrat e votimit

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2021*

kur dalin jashtë ambienteve publike kanë sensitivitetin e tyre për një mijë e një arsye nga të gjitha forcat politike. Veçanërisht këto qendra të cilët propozohen sot për miratim në ambiente private, kanë qenë qendra të cilat ne si parti politike si subjekt i kemi jo konstestuar, le të themi kemi pasur vërejtjet tona të cilat i kemi përcjellë zyrtarisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve qoftë dhe me argumentimin përkatës bindës ose jo dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka riverifikuar pranë drejtuesve të organeve të vetqeverisjes vendore dhe ka ardhur me këtë propozim. Parimisht ne nuk jemi dakord me aktin në vetvete jo për shkak se KQZ-ja nuk e ka verifikuar shqetësimin tonë, po për shkak të mungesës totale të besimit nga ana jonë të përgjigjeve të organeve të vetëqeverisjes vendore. Në ndryshim nga të gjithë proceset e tjera zgjedhore të kaluara të paktën sa mbaj mend unë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Komisioneri në këtë rast përballet me një situatë të pazakontë kur pothuajse 100% të organeve të vetëqeverisjes vendore dominohen nga përfaqësues të emëruar të të njëjntës forcë politike, e cila është gjithashtu garuese në këtë proces dhe veçanërisht drejtuesit e organeve të vetëqeverisjes vendore pavarësisht se në tejkalim të detyrës së tyre ligjore janë ngarkuar dhe investuar me përgjegjësi politike personale nga kryetari i maxhorancës dhe kryetari i forcës elektorale që garon kundër nesh. Si i tillë nuk janë më administratorë vendorë të cilët në këndvështrimin tonë kanë prioritet zhvillimin e një procesi normal zgjedhor, por në këndvështrimin tonë dhe të një pjese të madhe të elektoratit që përfaqësojnë janë veçse komisionerë edhe komisarë partiakë, të cilët kanë interesin e tyre elektoral parësor në këtë proces dhe më pas çështja e sigurimit të kushteve të barabarta të aksesit në këto qendra votimi kalon në plan të dytë ose të tretë. Të gjitha përgjigjet e tyre për të mos thënë që një pjesë e madhe e tyre rrëzohen edhe nga një logjikë e thjeshtë elementare janë krejtësisht të pabesueshme dhe nuk duhen të merren në konsideratë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Unë

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2021*

nuk mund të pranoj që po marr një rast nga rastet e propozuara që 8 qendra votimi, të cilat kanë qenë në Pallatin e Kulturës në Kamëz në mes të qytetit, Kryetari i Njesisë Vetëqeverisjes Vendore pretendon t'i zhvendos në ambient privat të 8 qendrat në të njëjtin ambient privat me pretendimin që për herë të parë që nga viti 2007 që unë vi përfaqësoj këtu në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dëgjoj që ambientet publike i kanë dhënë me qera dhe për këtë shkak duhet që procesi i votimit të zhvillohet në ambiente private të cilat ai i përcakton. Nuk e kam dëgjuar ndonjë herë është hera e parë më duket krejtësisht e papranueshme që në qendër të qytetit të Kamzës ku është Pallati i Kulturës që është qendra administrative pak kilometra nga Tirana nuk paska asnjë ambient tjetër publik që të shërbejë si qendra votimi por duhet vajtur në ambiente private të një zonje, të cilën nuk e njoh se kush është dhe nuk dua ta bëj objekt diskutimi. Pra, ka dhe gjëra që bien në kundërshtim dhe me logjikën e thjeshtë elementare të organizimit me rregulla normale të një procesi zgjedhor, thjesht dhe vetëm siç e thashë për arsye të presionit partiak që ushtrohet mbi këta komisarë partiakë që dominojnë Pushtetin Vendor. Çfarë mund të bëjë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duke qenë se ka dhe shtrëngesa kohore dhe sigurisht këtë vendimmarrje duhet ta sillte në vëmendje të Komisionerit për shkak dhe të shtrëngimit të kohës. Unë besoj se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka instrumentet që ta verifikojë dhe ta zgjidhë vet këtë çështje. Për fat të mirë janë ngritur KZAZ-të, për fat të mirë KZAZ-të janë në krye të detyrës me ato pak detyra sa kanë tani kaq larg procesit zgjedhor, por ka komisionerë të mjaftueshëm që i bëjnë ato KZAZ funksionale, të cilët pavarësisht se janë propozuar nga forca politike tashmë janë administratë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e pavarur nga organet e qeverisjes vendore. Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka instrumente të tjera siç janë inspektorët rajonalë dhe besoj se këto KZAZ-të të cilat akoma nuk kanë gjetur një moment rakordimi midis forcave politike dhe

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2021*

komisarëve vendor të emëruar. Propozoj zyrtarisht që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve t'ia kalojë për shqyrtim dhe verifikim KZAZ-ve dhe inspektorëve të saj vendorë, pra administratës së saj dhe vetëm pas verifikimit të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me përgjegjësinë e tyre institucionale që vet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u ka dhënë dhe besimin e detyrës t'i marrim e t'i miratojmë në qoftë se janë për t'i miratuar ose të gjejmë një zgjidhje më të mirë në qoftë se është për t'u gjetur një zgjidhje më e mirë, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Faleminderit zoti Kaso, ndërkohë kemi marrë dhe një opinion nga përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim në lidhje me këto qendra votimi për të cilat ata kanë shqetësime Qendra e Votimit 2943, Qendra e Votimit 2976, Qendra e Votimit 2957, Qendra e Votimit 2958 dhe për një qendër votimi në Mat për të cilin nuk kanë dhënë numrin po pretendohet se është pronari i ambientit ku do të vendoset kjo qendër votimi, ka lidhje farefisnie me kryetarin aktual të bashkisë që është përfaqësues i Partisë Socialiste. Unë do të propozoja që për shkak dhe të problematikës që kemi në raport me kohën, sepse sot është afati fundit i përgatitjes së listës së zgjedhësve. Këto qendrat e votimit thjesht për formalitet do t'i kalojmë sipas projektaktit por deri ditën e hënë drejtoria e komisioneve zgjedhore materialeve zgjedhore nëpërmjet inspektorit rajonal si më së pari nëpërmjet KZAZ-së të ngarkohet kryetar, nënkryetar i çdo KZAZ-je për të bërë verifikimet për këto qendra votimi, por ndërkohë të verifikojnë dhe mundësi të tjera, të eksplorojnë për mundësi të tjera të vendosjes së qendrave të votimit qoftë në ambiente publike që do të ishte rasti më i mirë, por ndoshta dhe në ambiente private për të cilat nuk ka rezerva nga partitë politike. Aktin po e miratojmë por me kushtin që ditën e martë të javës tjetër, ne do të kemi një seancë publike për t'i rikonsideruar të gjitha këto qendra votimi. Bazuar në një informacion të

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2021*

grumbulluar verifikimi të bërë nga KZAZ-të dhe nga drejtorja e nga stafi përkatës i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ky raport paraprakisht do t'u dërgohet edhe partive politike të gjitha gjetjet, faleminderit.

Vendimi nr.141

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2021*

15.03.2021
Ora 11:36

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për lirimin dhe emërimin e disa anëtarëve të KZAZ-së nr.7 Qarku Shkodër, KZAZ-së nr.9 Qarku Kukës, KZAZ-së nr.23 Qarku Durrës, KZAZ-së nr.32 Qarku Tiranë, KZAZ-së nr.55 Qarku Fier, KZAZ-së nr.63 Qarku Berat, KZAZ-së nr.71 Qarku Korçë, KZAZ-së nr.75 Qarku Korçë, KZAZ-së nr.91 Qarku Vlorë KZAZ-ve për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

- | | |
|--------------------------------------|-----------------------|
| 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve | Z.Illirjan Celibashi |
| 2.Stafi KQZ: | Z.Y.Merkaj, A.Tenolli |
| • Parti Politike: | PD (I.Kaso) |

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Bazuar nenit 32 paragrafi “2” i Kodit Zgjedhor, Partia SocialDemokrate e Shqipërisë në datën 2.03.2021 ka kërkuar lirimin dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.32 Qarku Tiranë gjithashtu ka kërkuar lirimin dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.75 Qarku Korçë. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim në datën 10.03.2021 ka kërkuar lirimin dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.7 Qarku Shkodër, lirimin dhe zëvendësimin e KZAZ-së nr.23 Qarku Durrës, lirimin dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.63 Qarku Berat, lirimin dhe zëvendësimin e KZAZ-së nr.71 Qarku Korçë, lirimin dhe zëvendësimin e KZAZ-së nr.75 Qarku Korçë, lirimin dhe zëvendësimin e KZAZ-së nr.91 Qarku

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2021*

Vlorë. Partia Socialiste e Shqipërisë në datën 13.03.2021 ka kërkuar lirimin dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.9 Qarku Kukës dhe lirimin dhe zëvendësimin e anëtarit të KZAZ-së nr.55 Qarku Fier. Pas verifikimit, KQZ i gjen në përputhje me nenin 30, 31 dhe 32 me propozimet e paraqitura. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive politike, zoti Kaso? Atëherë, vendoset:

1.Lirimi nga detyra anëtarëve të KZAZ-së nr.7 Qarku Shkodër, KZAZ-së nr.9 Qarku Kukës, KZAZ-së nr.23 Qarku Durrës, KZAZ-së nr.32 Qarku Tiranë, KZAZ-së nr.55 Qarku Fier, KZAZ-së nr.63 Qarku Berat, KZAZ-së nr.71 Qarku Korçë, KZAZ-së nr.75 Qarku Korçë, KZAZ-së nr.91 Qarku Vlorë sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi;

2.Të emërojë anëtarët e KZAZ-ve nr.7 Qarku Shkodër, KZAZ-së nr.9 Qarku Kukës, KZAZ-së nr.23 Qarku Durrës, KZAZ-së nr.32 Qarku Tiranë, KZAZ-së nr.55 Qarku Fier, KZAZ-së nr.63 Qarku Berat, KZAZ-së nr.71 Qarku Korçë, KZAZ-së nr.75 Qarku Korçë, KZAZ-së nr.91 Qarku Vlorë sipas lidhjes 2 bashkëlidhur këtij vendimi;

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së dhe njoftohen KZAZ-të përkatëse, faleminderit. Pikë tjetër në rendin e ditës nuk kemi. Seanca mbyllet!

Vendimi nr.142

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi Sino*

